


**AKT - THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"TAULANT" sh.p.k.**



Personi që nënshkruan më poshtë:

Ditika Qatipi, e bija e Hasanit, e datelindjes 11.03.1964, me banim ne Tirane, Blv. Zogu i I-re, nr. 97/5, me pasaporten nr. 0462735,

ka hartuar si më poshtë vijon Aktin e Themelimit të një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar të cilën ka vendosur ta emërtojë:

Shoqeria **"TAULANT"** sh.p.k.

Në mbështetje të ligjit nr. 7638 , datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", unë ortakja e vetme, Ditika Qatipi, vendosa krijimin e Shoqërisë me Pergjegjësi të Kufizuar **"TAULANT" sh.p.k.** për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

-I- Projektim objektesh ekonomike, civile, industriale, bujqesore, ushtarake, urbanistike, infrastrukture, topografi, hidrogeologji dhe gjeologji.

-II- Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi sipas kategorive:

Kategoria A: 1, 2, 3; Kategoria B: 1, 2; Kategoria C: 1,2; Kategoria D: 1, 2; Kategoria G: 3

-III- Zbatim sipas kategorive:

Kategoria 1; Kategoria 2: a, c, e; Kategoria 3: a, b, c; Kategoria 4: a, b, c; Kategoria 6: a, b; Kategoria 7: a; Kategoria 8: a; Kategoria 9: a, b, c, d; Kategoria 10: a; Kategoria 11: a, b; Kategoria 12: c, e, f; Kategoria 14: b, c
Punime elektrike dhe mekanike .

-IV- Vleresim te pasurive te palujtshme.

-V- Import–Eksport, shitje me pakice dhe shumice te mallrave industriale, elektro shtepiake, te ndertimit, te lendeve te para per ndertim dhe materiale inerte, te bojrave te llojeve te ndryshme, te materialeve hidrosanitare, elektrike, materialeve drusore, makineri e pjese kembimi, mallrave ushqimore, produkteve bujqesore e blektoriale, konfeksione.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mije) lekë.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe mbi 10 (dhjetë) vjetë.

Selia do të jetë ne Tirane Blv. Zogu i I-re, nr. 97/5.

Administratori i shoqërisë do të jetë Ditika Qatipi.

Përfaqësimi ndaj të tretëve do të bëhet nga administratori i Shoqerise.

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në Gjykatën e Shkalles Pare.

Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 dhjetor 2005.

Çdo vit tjetër financiar fillon më 1 janar dhë përfundon më 31 dhjetor.
Ky Akt - Themelimi është hartuar më 05.12.2005 në katër kopje origjinale duke patur fuqi të barabartë ligjore.

**Ortaku i vetëm
i Shoqërisë "TAULANT" sh.p.k.**

Ditika Qatipi

Ditika Qatipi
Ditika


REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 2708 REP.
NR. 688 KOL.

VERTETIM

Sot më datë 12.12.2005 (dymije e pese) para meje noteres Adelina Nini u parqit personalisht ortaku i vetëm i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "TAULANT" sh.p.k. **Ditika Qatipi**, e bija e Hasanit, e datelindjes 11.03.1964, me banim ne Tirane, Blv. Zogu i I-re, nr. 97/5, me pasaporten nr. 0462735 e cili më deklaroi se *Statuti* i mësipërm është hartuar sipas vullnetit të saj të lirë e të plotë dhe unë noterja duke e gjetur konform ligjit, e vërtetoj atë.

NOTERE

Adelina Nini



STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“TAULANT” sh.p.k.



Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “TAULANT” sh.p.k. (e cila ketu me poshte quhet “Shoqeria”) eshte themeluar ne baze te Aktit te Themelimit, nga ortaku:

Ditika Qatipi, e bija e Hasanit, e datelindjes 11.03.1964, me banim ne Tirane, Blv. Zogu i I-re, nr. 97/5, me pasaporten nr. 0462735

Kjo **SHOQERI**, ne perputhje me legjislacionin shqiptar e veçanerisht me Ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerine tregtare” krijohet nga **ORTAKU** i vetem i kesaj **SHOQERIE**, per te ushtruar veprimtari te ndryshme sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit dhe nga ky Statut.

NENI 1
EMERTIMI

SHOQERIA emertohet “TAULANT” sh.p.k.

SHOQERIA eshte person juridik dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te ketij **STATUTI** .

SHOQERIA do te quhet person juridik dhe do te veproje si e tille duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne gjykate, ndersa veprimtaria ekonomike fillon me regjistrimin e saj ne organet tatimore.

NENI 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se **SHOQERISE** eshte:

-I- Projektim objektesh ekonomike, civile, industriale, bujqesore, ushtarake, urbanistike, infrastrukture, topografi, hidrogjeologji dhe gjeologji.


-II- Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi sipas kategorive:

Kategoria A: 1, 2, 3; Kategoria B: 1, 2; Kategoria C: 1,2; Kategoria D: 1, 2; Kategoria G: 3

-III- Zbatim sipas kategorive:

Kategoria 1; Kategoria 2: a, c, e; Kategoria 3: a, b, c; Kategoria 4: a, b, c; Kategoria 6: a, b; Kategoria 7: a; Kategoria 8: a; Kategoria 9: a, b, c, d; Kategoria 10: a; Kategoria 11: a, b; Kategoria 12: c, e, f; Kategoria 14: b, c
Punime elektrike dhe mekanike .

-IV- Vleresim te pasurive te palujteshme.



-V- Import–Eksport, shitje me pakice dhe shumice te mallrave industriale, elektro shtepiake, te ndertimit, te lendeve te para per ndertim dhe materiale inerte, te bojrave te llojeve te ndryshme, te materialeve hidrosanitare, elektrike, materialeve drusore, makineri e pjese kembimi, mallrave ushqimore, produkteve bujqesore e blektoriale, konfeksione.

NENI 3 SELIA E SHOQERISE

Selia e **SHOQERISE** ndodhet ne Tirane Blv. Zogu i I-re, nr. 97/5.

SHOQERIA me vendim te organeve te saj kompetente, rast pas rasti, do te krijojë, transferoje dhe/ose anulloje seli dytesore, seli administrative, drejtori, filiale, dege, agjensi dhe zyra si ne territorin shqiptar ashtu edhe jashte vendit.

NENI 4 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e **SHOQERISE** eshte caktuar mbi 10 vjet.

Me vendim te **ORTAKUT te vetem** kohezgjatja e **SHOQERISE** mund te caktohet tej afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperm.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i **SHOQERISE** eshte 100.000 leke (njqind mije).

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar eshte nenshkruar ne teresine e saj nga Ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe me kontribute ne natyre.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themelor te **SHOQERISE** behet me vendim te **ORTAKUT TE VETEM** .

Fondi ne te holla qe vjen nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar depozitohet per llogari te **SHOQERISE** ne te gjitha Bankat qe ndodhen ne teritorin e Shqiperise .

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar behet me akt noterial .

NENI 6 VEPRIMET FINANCIARE

Veprimet financiare te **SHOQERISE** pasqyrohen ne llogarite (kontabilitetin) e saj, duke aplikuar kriteret e dispozitat mbi kontabilitetin e shoqerive tregtare te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

NENI 7 BLERJET E SHOQERISE



SHOQERIA disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj.

SHOQERIA ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te çdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve.

NENI 8 BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

SHOQERIA per ushrimin e aktivitetit krijon fondet e saj. Perberja, madhesia e tyre, burimet e krijimit, perdorimi e rregullimi i çdo fondi te veçante vendoset nga **ORTAKU I VETEM** i saj, duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

SHOQERIA disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundshme gjate veprimtarise se **SHOQERISE** do te mbuloohen nga fondet perkatese apo fondet rezerve ose edhe me zmadhimin e kapitalit themeltar.

Te gjitha pasurite e **SHOQERISE** pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare.

Bilanci dhe llogarite e **SHOQERISE** perpilohen e mbahen nga Administratori.

Viti financiar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron ne daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

NENI 9 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

SHOQERIA administrohet nga **ADMINISTRATORJA** e saj, Znj. **Ditika Qatipi**, e cila eshte njekohesisht edhe Ortake e vetme e kesaj shoqerie dhe e perfaqeson **SHOQERINE** ne mardhenie me te tretet.

ORTAKU I SHOQERISE mund ti delegoje kopetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Vendimet e **ORTAKUT** te vetem evidentohen ne nje regjister te vecante.

NENI 10 ORTAKU I SHOQERISE

ORTAKU I SHOQERISE ushtron te gjitha kompetencat, te drejtat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e **SHOQERISE** te parashikuara nga ky statut, Akti i Themelimit si dhe nga legjislacioni tregtar shqiptar.

Ai ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet qe i konsideron te domosdoshme per realizimin e qellimeve te **SHOQERISE**, pa cenuar interesat e tij.

NENI 11

ORTAKU i vetem i cili eshte njekohesisht edhe administratori i **SHOQERISE** pergjigjet per te gjithe veprimtarine e **SHOQERISE** qe nga momenti i themelimit te saj.



NENI 12
MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes ndermjet **SHOQERISE**, filialeve e agjensive te saj (nese krijohen te tilla) dhe punonjesve te saj rregullohen me kontraten e punes. Per ceshnje te paparashikuara ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.

NENI 13
NDRYSHIMET NE STATUT

Ndryshimet ne **STATUT** mund te behen me vendim te **ORTAKUT te vetem** dhe sipas dispozitave ligjore te parashikuara ne ligjin «Per Shoqerite Tregtare».

NENI 14
SHNDERRIMI I SHOQERISE

SHOQERIA mund te shnderrohet ne nje shoqeri kolektive, komandite apo anonime me vendim te **ORTAKUT** te saj.

Shnderrimi i **SHOQERISE** ne nje shoqeri tjetere do te konsiderohet i vlefshem vetem duke respektuar dispozitat ligjore te parashikuara nga ligji «Per Shoqerite Tregtare».

NENI 15
PRISHJA E SHOQERISE

SHOQERIA priset ne rastet kur:

- a. mbaron afati i parashikuar ne Aktin e Themelimit .
- b. nuk mund te realizohet objekti i **SHOQERISE** sipas Aktit te Themelimit dhe Statutit.
- c. nje vendim te tille e merr **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**.

NENI 16
LIKUJDIMI I SHOQERISE

Likujdimi i **SHOQERISE** do te behet sipas dispozitave te legjislacionit falimentar shqiptar ne fuqi ne çastin e likujdimit.

ORTAKU i vetem vendos rregullat per proceduren e likujdimit si dhe per personat qe do ti aplikojne ato.

NENI 17
DISPOZITE E FUNDIT

Ky **STATUT** hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te **SHOQERISE** ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky **STATUT** u njoh dhe u nenshkrua nga **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE** ne Tirane me 05.12.2005.

ORTAKU I SHOQERISE
“TAULANT” sh.p.k.

Ditika Qatipi

Ditika Qatipi
